



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKAN KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Plani i Dëshmive Pratypuar/Preliminary Accessed/Delivered	03-06-2021	1	100 god year
Organ/Platoni Organ/Structure Org./Name	No. Prad. Br. Prod. Prod. No.	Shitja/ Prilog Appendix	Sasia Kantimit Quantity
SKYDIBACK	2849/2021		1/7



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.369/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.74/20 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën e datë 13.11.2019 me numër A.nr.710/2019 të parashtruar nga grup ankuesish të përfaqësuar nga ankuesja

me adresë rruga "Ndue Perllëshi", pa nr. Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit-Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënja e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 03.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.710/2019 e datës 13.11.2019 e parashtruar nga grup ankuesish,

A r s y e t i m

Ankuesit e punësuar në Komunë të Prishtinës, si në vijim: në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimit", në sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për arkitekturë", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin

për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimtarisë", në sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për arkitekturë", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për arkitekturë", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për arkitekturë", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 15.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për arkitekturë", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për makineri", në Sektorin për investime kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimtarisë", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Udhëheqës i sektorit menaxhim të kontratave të ndërtimeve të lartë", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, me koeficientin 7 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar për rrjete dhe matje gjeometri", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me gradë 11(niveli teknik administrativ) në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 11.07.2018, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për emergjenca", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.07.2020, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin e Investimeve Kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 15.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar për rrjete dhe matje gjeometri", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me gradë 11(niveli teknik administrativ) në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave,

në vendin e punës "Zyrtare e lartë për gjeodezi", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të lartë, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 15.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Asistente administrative 4", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me gradë 11(niveli teknik administrativ), në bazë të Akte emërimit të datës 15.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me gradë 11(niveli teknik administrativ), në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimtari", në Sektorin Investime Kapitale, me gradë 11(niveli teknik administrativ), në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar teknik i ndërtimtari", në Sektorin Investime Kapitale, me grade 11(niveli teknik administrativ), në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë i ndërtimtarisë", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë i ndërtimtarisë", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 01.02.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtare e lartë për ndërtimtari", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.07.2017, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për emergjenca", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.07.2020, në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë për makineri", në Sektorin për Menaxhimin e kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 13.07.2020 në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë i ndërtimtarisë", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 13.03.2017 në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës, "Zyrtare e lartë për komunikacion rrugor", në Sektorin Investime Kapitale, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 14.03.2017 në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, në vendin e punës "Zyrtar i lartë i ndërtimtarisë", në Sektorin për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017 në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, dhe në vendin e punës "Zyrtar i lartë i ndërtimtarisë", në Sektorin

për Menaxhimin e Kontratave për ndërtim të ulët, me koeficientin 8 në bazë të Akte emërimit të datës 10.03.2017 në Departamentin për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, të cilët datë 04.10.2019 kanë parashtruar kërkesë nr.14-070/01-0244337/19 tek Kryetari i Komunës së Prishtinës, nënkryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, për masë stimuluese të shtesës sipas Vendimit e Qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008, dhe Aneksi I, të listës dhe titujve të punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë dhe shumë për këto pozita, për kategorinë e veçantë të fushës së Teknologjisë Informativë dhe Inxhinjeringut.

Ankuesit për shkak të mos pranimit të përgjigjes nga Komuna e Prishtinës, në pajtim me nenit 24 të Ligjit Nr. 06/L- 114 për Zyrtarët Publike, me datë 13.11.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 5347/2019, me pretendime ankimore për masë stimuluese të shtesës duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008, për kategorinë e veçanta të fushës së Teknologjisë Informativë dhe Inxhinjeringut.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.11.2019, ankesën e ankuesve e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës si dhe poashtu ka dërguar një E-mail më datë 21.05.2021, nga se deri në këtë datë nga organi i punësimit nuk kemi marrë përgjigje në ankesë, ndërsa mbi bazë të këtij emaili të datës 21/05/2021, më datë 02.06.2021 Këshilli ka pranuar shkresat përcjellëse dokumentacionin e kërkuar, përmes E-mailit zyrtar të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri në tetor 2020, ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesve, ndërsa më datë 08.10.2020 janë zgjedhë 5 anëtar të keshillit me ç' rast më datë 14/10/2021 janë themeluar edhe kolegjet profesionale nga ana e keshillit dhe nga kjo kohë është funksionalizuar keshilli me të gjitha përgjegjësit për vendosje në lidhje me ankesat e palëve.

Ankuesi, i pakënaqur me njoftimin e datës 11.12.2019, të Keshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13/01/2020 ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 29.04.2021, me numër A.nr.74/20, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësve, duke anuluar njoftimin e datës 11.12.2019, të Keshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar keshillin që të vendos lidhur me ankesën e ankuesve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Aktgjykimi nr.74/20 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Ankesën A.nr.710/2019 me numër protokollit 5347/2019 të datës 13.11.2019 e parashtruar nga grup ankuesish në Keshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë Nr.14-070/01-0244337/19 e datës 04.10.2019 përmes së cilës është parashtruar kërkesa tek Kryetari i Komunës së Prishtinës, nënkryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore; Kërkesë Nr.14-070/01-0248688/17 e datës 04.10.2017; Kërkesë nr.14-070/01-0314475/17 e datës 27.12.2017; Kërkesë e datës 10.11.2017; Kërkesë e datës 25.03.2017; Vendimin e Qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008, bashkangjitur

vendimin Nr.01/39 të datës 08.10.2008, të bashkangjitur Aneks I, lista e titujve të punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë dhe shumën për këto pozita.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vendosjes meritore në lidhje me këtë lëndë, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesat e ankuesve,

janë të pa vazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesve të cilët pretendojnë që të përfshihen në listën e pozitive për shtesë në pagë për kategorinë e veçantë të teknologjisë informatike dhe inxhinjeringut, sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, me nr.02/39 të datës 08.10.2008.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesit me datë 04.10.2019 kanë parashtruar kërkesë me nr.14-070/01-0244337/19 tek Kryetari i Komunës së Prishtinës, Nënkryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore në Komunë të Prishtinës, të cilët nuk i janë përgjigjur kërkesës së ankuesve, dhe mbi këtë bazë ankuesit pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 06/L- 114 për Zyrarët Publike me datë 11.09.2019, i cili ka qenë në fuqi deri me datë 18.11.2019, i cili është pezulluar me masë të përkohshëm me datë 19.11.2019, me Vendim të Gjykatës Kushtetuese, dhe ankuesit në pajtim me nenin 24 paragrafin 3 të Ligjit Nr. 06/L- 114 për Zyrarët Publik, kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokolli 5347/2019, për shkak të mos përgjigjes në kërkesën e datës 04.10.2019 nga Zyrtari Kryesor Administrativ i Komunës së Prishtinës gjegjësisht Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me pretendime ankimore për masë stimuluese të shtesës duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr.02/39 të datës 08.10.2008, për kategorinë e veçanta të fushës së Teknologjisë Informatike dhe Inxhinjeringut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitive dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinjeringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrencës për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *"1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me udërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë.*

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesve për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Po ashtu, Kolegji lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimor të ankuesit, ka analizuar dispozitat e nenit 17 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ku përcaktohet se: *"1. Për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është shumë më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit për ato pozita ose lloje të pozitave nga administrata publike, ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut, e cila mund të paguhet për këto pozita ose lloje të pozitave. 2. Kërkesa për miratimin e kësaj shtese nga Qeveria duhet të bazohet në një analizë, e cila tregon se për këto pozita ose lloje të pozitave: 2.1. çmimi i tregut për aftësitë në fjalë është shumë më i lartë se paga që ofrohet nga Shërbimi Civil; 2.2. përpjekjet për rekrutimin e personelit me pagë të Shërbimit Civil kanë dështuar dhe/ose shkalla e dorëheqjeve është e papranueshme; 2.3. pritjet se shtesa do të ndikojë në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit. 3. Kushtet dhe metoda për llogaritjen e shumës së shtesave mbi pagën bazë për kushtet e tregut përcaktohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Qeveria, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa".*

Bazuar në nenin 8 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përcakton se: *"Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, për aprovimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut, institucioni duhet t'i ofrojë ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën që përmban: 2.1 Arsyeshmërinë për pagimin e shtesës për kushte të veçanta të tregut për pozitën përkatëse, së bashku me një analizë, e cila dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, duke përfshirë informata mbi nivelin e pagës që paguhet nga organizatat e tjera në tregun e Kosovës për pozita të ngjashme. 2.2 Listën e pozitave përkatëse, gradat dhe numrin e nëpunësve civil për çdo pozitë dhe 2.3 Koston vjetore të vlerësimit financiar të shtesave për kushtet e tregut të punës".*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria e Republikës së

Kosovës që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitive për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitive në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitive përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Si dhe shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.369/2021, datë 03.06.2021.

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesve të përfaqësuar nga ankuesja*
- *Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative;*
- *Kryetarit të Komunës së Prishtinës ;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Komunë të Prishtinës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

